



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE INVESTIMEVE TË HUAJA

Nr. 10832 /8
Prot

Vlorë, më: 28. 09. 2022

DËGJESË PUBLIKE

Mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 si dhe planifikimi për Projekt Buxhetin e vitit 2023 për Bashkinë Vlorë

RAJONI 2

Data 22.09.2022: ora 10.00

Pjesëmarrës: Banorë, biznesmen, Drejtore të Administratës dhe Institucionit të Bashkisë Vlorë, shoqëri civile.

Orest Ruçaj-Kryetar i Rajonit 2. Ju falenderoj për pjesëmarrjen, jemi mbledhur për të diskutuar mbi projekt buxhetin e vitit 2023 dhe planifikimin e programit afatmesëm të buxhetit 2023-2025. Paraqisni shqetësimet dhe problematikat që ju shqetësojnë.

Daut Zeraj: Këto dëgjesa organizohen në cdo rajon dhe në cdo njësi administrative me qëllim prezantimin e programit buxhetor afatmesëm si dhe për të mbledhur kërkesat tuaja për projekt buxhetin e vitit 2023.

Disa nga treguesit e programit buxhetor afatmesëm si dhe projektet në zbatim për vitin 2023 janë: në strukturën e administratës nuk janë parashikuar ndryshime të mëdhaja për programin buxhetor afatmesëm 2023-2025 në raport me vitin 2022.

Për investimet 2022 shuma e dhënë nga granti është 565 milion lekë. Për vitin 2023 është parashikuar një ritje rrëth 6% dhe me këtë ritëm vazhdon edhe për të ardhurat dhe shpenzimet. Për vitin 2023 parashikohet rritje nga 2 miliard në 2 miliard e 400 mijë lekë.

Për vitin 2024 në 2 miliard e 505 mijë lekë dhë në vitin 2025 në 2 miliard 610 milion.. janë parashikuar shpenzimet në sektorin e pastrimit, sportit, artit, arsimit etj.

Një vëmendje kanë investimet: për vitin 2022-299 milion, në vitin 2024-422 milion, në vitin 2025-431 milion ose rrëth 28% e buxhetit.

Investimet janë kryesisht në sektorin e arsimit, për kopshte, cerdhe, dhe arsimi bazë.

Për ndërmarrjen publike investimet për vitin 2022 ishin parashikuar 325 milion dhe për vitin 2025 rreth 410 milion lekë.

Në sektorin e pastrimit për vitin 2022 ishin parashikuar 355 milion, për vitin 2023 parashikohet një rritje rreth 13% dhe në vitin 2025 janë parashikuar rreth 6% më shumë.

Për rajonin 2 janë parashikuar sistemim të rrugëve, trotuarave, mirëmbajtje dhe gjelbërim, pastrim, s'ka investime të mëdhaja. Është parashikuar rruga "Shaban Demiri", rruga "Dhimiter Konomi" dhe rruga "Pelivan Leskaj".

Kërkesat tuaja do vlerësohen sipas prioriteteve dhe buxhetit të parashikuar nga të ardhurat dhe granti.

Deri tani është shpenzuar rreth 80% nga buxheti i parashikuar. Investimet që kërkojnë angazhim dhe jo fonde të mëdhaja, por fond me vlera të vogla, do të punohet sipas porosisë që kemi edhe nga Kryetari i Bashkisë, mos të neglizhohen punët por të realizohen detyrat.

Mirëpresim vërejtjet dhe propozimet tuaja.

Qytetari : Përgjatë lungomares, për të gjitha bizneset, si dhe për biznesin tim personalisht, është problem mungesa e parkimit të makinateve. Jemi taksapagues të rregullt. E kemi ngritur gjithmonë si shqetësim por nuk jemi dëgjuar. I dërgojmë foto dhe mesazhe dhe nuk na kthejnë përgjigje. Duhet ti jepet një zgjidhje sepse kemi bërë investime, paguaj cdo taksë dhe po falimentojmë.

Qytetari : Banorët në lagjen Isa Boletini. Problematikat i kemi me pastrimin, pucetat qe bllokohen, përballet shkollës "Ismail Qemali" rrjedhin ujë tubacionet e ujit të pijshëm, ka grapa të mëdhaja e të vogla. Këto duken gjëra të vogla por duhen pasqyruar në buxhet.

Qytetari : Pallati me nr.886 te Aleksandria, duhet pastruar nga mbeturinat.

Qytetar: kanalizimet dhe mbeturinat pa pastruar te L.Pavarësia.

Qytetar: 3 rrugicat te Dush Strati, banorët 75 familje dhe vetëm 15 marrin shërbimin e ujit të pijshëm dhe kjo ka krijuar problematika ne linjën e ujësjellëit.

Qytetari : kam këto problematika;

1. Uji i pijshëm, ca po bëhet, që jemi akoma me boliera? Isa Boletini.
2. Bulevardi kryesor eshtë në rregull por pas tij është situata si në fshat, 200m pas Pallatit të Sportit s'ka infrastrukturë. I kemi bërë dhe herë tjeter kërkesat dhe ankesat. Cfarë projekti keni parashikuar?
3. Në brendesi të lagjeve vazhdohet me gardhe dhe ndërtime pa leje, cfarë po bëni? I kontrollon policia bashkiakë?
4. Administrata të punoj dhe mos të na përcillni por të përgjigjeni për kërkesat që ju bëjmë.

5. Duam të irregullohet dhe rikonstruktohet lapidari historik që ndodhet në ishullin e Sazanit. Të bëhet rikonstruksioni për ti rritur vlerat historike zonës dhe ishullit.

Daut Zeraj: Për investime madhore në përmirësimin e sektorit të ujit të pijshëm, mbajmë komunikime me ministrinë dhe qeverinë, sepse buxheti nga të ardhurat e bashkisë nuk e mundëson investimin.

Për vitin 2022 ishin planifikuar rrëth 42 milion lekë investime, sepse kaq e kishim mundësinë. Për sa i përket përgjegjësive dhe detyrimeve të strukturave administrative keni të drejtë të kërkonit llogari dhe përgjegjshmëri. Do ti trajtojmë në vazhdimësi.

Rregullimi i Lapidarit në ishullin e Sazanit shikohet për buxhetin e 2023.

Qytetari: Kemi probleme, na i zgjidhni, janë detyrimet tuaja.

Daut Zeraj: Jemi për të mbledhur shqetësimet tuaja.

Qytetari : Shtrimi i rrugës midis Albatros dhe Pallatit të Hasanit si dhe shtrimi I rrugës Shaban Demiraj, kjo të lidhet me rrugen e Centrales.

Qytetari : Nga zjarrfiksja deri poshtë flitet për një treg. Nuk është bërë.

Qytetari : Pas rajonit, janë tre rrugicat që duhen rregulluar dhe tubacionet e ujit.

Orest Ruçaj: Ju falenderoj për pjesëmarrjen!

Hartoi

Albana Naçi

Koordinatore për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Bashkia Vlorë